



RREGULLORE E CERTIFIKIMIT PËR SISTEMET E MENAXHIMIT –SISTEMET E MENAXHIMIT ANTIKORRUPSION–

PËRMBAJTJA

1. SYNIMI DHE ZBATIMI.....	2	5.3. KOHËZGJATJA E AUDITIMIT	5
2. TERMINOLOGJIA DHE PËRKUFIZIMET	2	5.4. KRYERJA E AUDITIT	6
3. DOKUMENTET REFERUESE.....	3	5.5. CERTIFIKIMI I ORGANIZATAVE ME SHUMË SELI (MULTI-SITE)	6
4. KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR DHËNIEN E CERTIFIKIMIT	3	6. PËRGJEGJËSITË E PALËVE.....	6
5. PROCESI I CERTIFIKIMIT	4	6.1. TË PËRGJITHSHME.....	6
5.1. KËRKESË PËR OFERTË.....	4		
5.2. PËRCAKTIM I NUMRIT TË PUNONJËSVE.....	4		

TABELA E RISHIKIMEVE

N°	DATA	PËRSHKRIMI	PËRGATITI (RSG)	RISHIKOI (DO)	MIRATOI (DG)
00	11.09.2017	Botimi i parë	A. Llavda	A. Llavda	E. Avxhiu
01	24.11.2017	Përshtatje me udhëzimet e qarkores Accredia 28/2017	A. Llavda	A. Llavda	E. Avxhiu
02	29.05.2018	Ndryshime në vijim të analizës dokumentale	A. Llavda	A. Llavda	E. Avxhiu

1. SYNIMI DHE ZBATIMI

Qëllimi i këtij dokumenti është të bëjë shpjegimet përkatëse për procedurat e zbatuara nga AXE REGISTER në lidhje me veprimtaritë e certifikimit të sistemeve të menaxhimit për parandalimin e korrupsionit (ABMS). Kjo rregullore është pjesë e integruar e rregullores RG CE.01 “Rregullore për certifikimin e sistemeve të menaxhimit” të AXE REGISTER, kërkesat e të cilës janë plotësisht të zbatueshme dhe të detyrueshme në kryerjen e procesit të certifikimit ABMS.

Dispozitat në përmbajtje të kësaj rregulloreje, njësoj si ato të RG CE.01, kanë vlerë kontraktuale si për AXE REGISTER ashtu edhe për organizatën që kërkon certifikimin e sistemit të menaxhimit për parandalimin e korrupsionit (i njohur edhe si sistem i menaxhimit antikorrupsion - AMBS), zbatuar në përputhje normën ISO 37001.

Termi “proces i certifikimit” nënkupton veprimtaritë që lidhen me certifikimin fillestar, mbikëqyrjen, ricertifikimin, zgjerimin/reduktimin, pezullimin dhe tërheqjen e certifikimit.

Kjo rregullore zbatohet në mënyrë të njëtrajtshme dhe të paanshme për të gjitha Organizatat që kërkojnë certifikimin e sistemit të tyre të menaxhimit antikorrupsion me AXE REGISTER, në përputhje me kërkesat e organizmave të certifikimit të sistemeve të menaxhimit dhe rregullores RG CE.01 të AXE REGISTER. Qasja ndaj shërbimeve të tilla nuk është e kushtëzuar dhe as nuk varet nga përmasat e organizatës që bën kërkesën apo nga anëtarësimi i saj në grupe apo shoqata të caktuara. Kërkesa mund të bëhet nga çdo organizatë e çdo lloji, përmase dhe natyre.

Certifikimi lëshohet vetëm për një person juridik dhe përfshin të gjitha selitë, degët, selitë dytësore, veprimtaritë dhe proceset e kryera nga organizata. Nuk lejohen përjashtime nga proceset apo funksionet që kryhen brenda të njëjtit territor shtetëror.

Është i mundur kufizimi i zbatimit për territore shtetërore të caktuara, megjithatë fusha e zbatimit duhet të përfshijë proceset dhe veprimtaritë e ndjeshme¹ të kryera jashtë vendit nën përgjegjësinë dhe kontrollin e drejtpërdrejtë të organizatës (si: zyra e përfaqësimit ose seli dytësore, agjentë ose ndërmjetësues). Ky aspekt duhet përcaktuar në mënyrë të qartë në certifikatë. Në rastet kur veprimtaritë/proceset e ndjeshme, edhe ato jashtë vendit, për grupet e shoqërive, kryhen nga shoqëri të tjera të grupit (kompani lider, dhe/ose të kontrolluara), atëherë zbatohet paragrafi 8.5 i ISO 37001.

Ashtu si edhe për veprimtaritë e certifikimit të sistemeve të tjera të menaxhimit, për të siguruar paanshmëri dhe kompetencë, veprimtaria e AXE REGISTER i nënshtrohet kontrollit të një komiteti të veçantë i quajtur Komiteti për Ruajtjen e Paanshmërisë (CSI) të përbërë nga përfaqësuesi të palëve të interesuara për procesin e certifikimit.

¹ *Veprimtari dhe procese të ndjeshme janë (por jo vetëm): financa dhe kontrolli, tregtia, agjentë dhe rrjeti i shitjeve, furnizimi, figura institucionale dhe organizma sociale, funksionet e drejtuesve dhe të Këshillit Administrativ, audit i brendshëm, menaxhimi i licencave, i tenderave dhe i autorizimeve, menaxhimi i burimeve njerëzore (përfshirë menaxhimin, përzgjedhjen, rekrutimin dhe përparimin në karrierë), administrimi i menaxhimit të parave, të blerjeve, menaxhimi i donacioneve, marrëdhënia me autoritetet institucionale dhe organet e kontrollit, menaxhimi i sponsorizimeve, menaxhimi i çështjeve gjyqësore, i ankesave, i shërbimeve informatike, menaxhim i sigurisë, veprimtaritë e kontrollit dhe të testimit.*

2. TERMINOLOGJIA DHE PËRKUFIZIMET

Përveç termave të përcaktuar në Rregulloren RG CE.01 § 2 dhe në standardet e përmendura në të, për certifikimin për ABMS zbatohen përkufizimet e normës ISO 37001, të versionit të fundit, duke vënë theks të veçantë në termat e mëposhtëm:

Korrupsion	Ofrimi, premtimi, dhënia, pranimi ose kërkesa për të marrë avantazhe të paligjshme (favorizim) me vlerë (ekonomike ose jo), drejtpërdrejtë ose tërthorazi dhe pavarësisht nga vendndodhja, në kundërshtim me ligjet në fuqi, si nxitje ose shpërblim për një person që vepron ose refuzon të verprojë në përputhje me detyrat e këtij personi.
Organizatë	Individ ose grup individësh të cilët mbajnë funksionet e tyre me përgjegjësitë, autoritetet dhe marrëdhëniet për të arritur qëllimet e veta. Shënim 1. Koncepti i organizatës përfshin (por nuk kufizohet) individë sipërmarrës, ndërrmarje, shoqëri, firmë, korporatë, autoritet, partneritet, organizata bamirësie ose institucione, si të ndara ose kombinime të tyre, të përbëra nga persona juridik ose jo, publike ose private. Shënim 2. Për organizatat me më shumë se një njësi operative, një ose më shumë njësi operative mund të përkufizohen si një organizatë.



Palë të interesuara	Individ ose organizatë që mund të ndikojë, mund të ndikohet, ose të perceptojë veten si të ndikuar nga një vendim ose veprimtari.
Drejtues të lartë	Individ ose grup individësh të cilët kontrollojnë dhe drejtojnë organizatën në nivelin më të lartë Shënim 1. Drejtuesit e lartë kanë fuqinë e delegimit të autoritetit dhe të sigurojnë burime brenda organizatës. Shënim 2. Nëse fusha e veprimtarisë e sistemit të menaxhimit mbulon vetëm një pjesë të organizatës, termi drejtues të lartë u referohet atyre që drejtojnë dhe kontrollojnë atë pjesë të organizatës.
Bord drejtues	Grup ose organi i cili ka përgjegjësinë përfundimtare dhe autoritetin në lidhje me veprimtarinë, administrimin dhe politikën e organizatës, aty ku drejtuesit e lartë përgjigjen dhe nga të cilët kontrollohen. Shënim 1. Jo të gjitha organizatat, veçanërisht ato të vogla, kanë një bord drejtues i cili është i ndarë nga drejtuesit e lartë. Shënim 2. Një organ drejtues mund të përfshijë (por nuk kufizohet), këshillin drejtues, komitetet drejtuese, bordin mbikëqyrës, anëtarët e këshillit administrativ dhe supervizorët.
Funksioni i konformitetit për parandalimin e korrupsionit	Personi ose personat me përgjegjësi dhe autoritet për funksionimin e sistemit të menaxhimit për parandalimin e korrupsionit.
Personeli	Drejtues, zyrtarë, punonjës, punonjës të përkohshëm dhe vullnetarë të organizatës.
Bashkëpunëtorë	Palë e jashtme me të cilën organizata ka ose planifikon të krijojë marrëdhënie tregtare të çdo lloji.
Konflikt interesi	Situatë në të cilën interesat tregtare, ekonomike, familjare, politike ose personale mund të ndikojnë gjykimin e individëve gjatë kryerjes së detyrave të tyre për organizatën.

Termi "korrupsion" këtu i referohet normës ISO 37001 dhe përfshin të gjitha veprimtarinë, të cilat edhe pse në dukje të ligjshme, janë (drejtpërdrejt ose tërthorazi) të lidhura me rreziqet e korrupsionit dhe që paraqiten si pengesë për realizimin e interesit të përgjithshëm përfundimtar, për të cilat janë përgjegjëse si organizatat publike ashtu edhe ato private (si organizatat jofitimprurëse, kooperativat, të shëndetësisë, shoqëritë private që kontraktajnë shërbime publike, organizatat joqeveritare).

3. DOKUMENTET REFERUESE

Përveç normave dhe dokumenteve të përfshira në RG CE.01 "Rregullore për certifikimin e sistemeve të menaxhimit" të AXE REGISTER, janë të zbatueshme dhe dokumentet e mëposhtme:


ISO 37001:2016 – Vlerësimi i përputhshmërisë: kërkesat për organizmat që kryejnë auditime dhe certifikime për sistemet e menaxhimit.

Rregullore – Qarkore Teknike Accredia N° 28/2017 - Normativa për akreditimin e skemës së certifikimit ISO 37001 -Parandalimi i korrupsionit (e vlefshme për territorin italian).

4. KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR DHËNIEN E CERTIFIKIMIT

Përveç dispozitave të përfshira në rregulloren me titull RG CE.01 "Rregullore për certifikimin e sistemeve të menaxhimit"; për marrjen e certifikimit organizata duhet:

- Të tregojë se sistemi i menaxhimit antikorrupsion zbatohet prej të paktën tre muajsh në kohën kur kryhet auditi dhe se është në përputhje me kërkesat e normës ISO 37001, me kërkesat e kësaj rregulloreje dhe të atyre specifike të vendosura nga organizmi i akreditimit;
- Të ketë përcaktuar dhe dokumentuar fushën e zbatimit të sistemit;
- Të ketë formuluar dhe përcaktuar politikën për parandalimin e korrupsionit, procedurat, kontrollet, dhe komunikuar ato palëve të interesuara, së bashku me programin përkatës;
- Të ketë zbatuar kontrole financiare të nevojshme për uljen e rreziqeve të korrupsionit;
- Të ketë përcaktuar procedurat e duhura të mbikëqyrjes;
- Të ketë përcaktuar detyrimet kontraktuale të zbatueshme;
- Të ketë përcaktuar saktësisht mjediset, hapësirat dhe rreziqet e lidhura me veprimtarinë e saj;
- Të ketë përcaktuar strukturën organizative, tipologjinë dhe kompleksitetin e veprimtarive të saj;
- Të ketë identifikuar lidhësit, angazhimin dhe përgjegjësinë, organet dhe autoritetet vendimarrëse, bashkëpunëtorët, palët e interesuara me rëndësi për ABMS, subjektet ndaj të cilave është në gjendje të kryejë një kontroll, ndërveprimet e mundshme me zyrtarë publikë, dhe ka kërkuar nënshkrimin nga bashkëpunëtorët të një marrëveshjeje angazhimi për parandalimin e korrupsionit;
- Të ketë bërë vlerësimin e rrezikut dhe të ketë treguar kujdesin e duhur për projektet dhe partnerët e biznesit të organizatës;
- Të ketë kryer trajnimet e duhura në lidhje me parandalimin e korrupsionit.
- Të ketë vënë në zbatim procesin e raportimit, monitorimit, hetimit dhe të analizës së drejtorisë dhe të organit qeverisës, nëse ka;
- Të ketë zbatuar veprime korrigjuese dhe për përmirësimin e vazhdueshëm.

	RG CE.01-01	Rev: 02
	RREGULLORE PËR CERTIFIKIMIN E SISTEMEVE TË MENAXHIMIT	Datë: 29.05.2018
	SISTEMET E MENAXHIMIT ANTIKORRUPSION	Faqe 4 nga 6

5. PROCESI I CERTIFIKIMIT

5.1. KËRKESË PËR OFERTË

Në përputhje me rregulloren me titull RG CE.01 "Rregullore për certifikimin e sistemeve të menaxhimit", certifikimi për ABMS parashikon përcjelljen nga ana e organizatës të:

- kërkesës për ofertë, duke përdorur formularin përkatës të quajtur "Kërkesë për ofertë", me qëllim mbledhjen e të dhënave të nevojshme për të përcaktuar zbatueshmërinë e kësaj kërkesë si dhe përgatitjen e ofertës përkatëse.
- Formularit "Kërkesë për certifikim-shtojcë ABMS", që kërkon informacione specifike në lidhje me fushën e certifikimit dhe veçanërisht në lidhje me:
 - Kuotimet e shoqërisë në bursë;
 - Pasjen e kërkesave të tilla, që e bëjnë organizatën të krahasueshme me një organizëm të së drejtës publike;
 - Masat e zbatuara për parandalimin dhe kontrollimin e rreziqeve të korrupsionit;
 - Pjesëmarrjen në tendera;
 - Përfitime për financime dhe kompensime nga sektori publik;
 - Procedime gjyqësore në lidhje me fenomenin e korrupsionit në të kaluarën ose aktualisht¹⁾
 - Informacione në lidhje me veprimtari dhe procese që konsiderohen si të ndjeshme nga organizata dhe në lidhje me punonjës të përfshirë (shiko paragrafin 5.2);
 - Ushtrimin e kontrollit ndaj organizatave të tjera, duke saktësuar karakteristikat e një kontrolli të tillë (pjesëmarrje në kapital, detyrime kontraktuale etj.)

Theksohet që dërgimi i formularit të plotësuar dhe të nënshkruar bëhet me të vetmin qëllim që të jepen të dhënat e nevojshme për të formuluar ofertën dhe nuk janë detyruese as për Organizatën dhe as për AXE REGISTER. Për formalizimin e procesit të certifikimit klienti duhet të dërgojë më vonë edhe Ofertën e kundërfirmosur.

In fact, the initial certification audit takes place in organizations of which ACM can not have ex ante data, except those obtained from the spontaneous declarations of the same organizations, or for news learned from the media

¹⁾Një element i rëndësishëm në procesin e certifikimit është pikërisht informacioni që AXE REGISTER merr nga organizata që bën kërkesën. Në fakt, audit për certifikimin fillestar (Faza 1) kryhet në organizata, për të cilat AXE Register nuk mund të ketë të dhëna paraprake, përveç atyre të marra nga organizata ose nga lajmet përmes mediave. Prandaj, informacioni i dhënë është shumë i rëndësishëm pasi nuk është gjithmonë e mundur të kuptohet nëse shoqëria, e cila edhe pse ndjek procedurat e duhura (të përshtatura ose jo dhe në zbatim të legjislacionit për krimin në korporata), përfaqëson një "mjedis patologjik" në kontekstin e korrupsionit. Ky standard ka qëllim parandalues, i cili nuk përputhet me mjediset patologjike të biznesit, ku në fakt është i nevojshëm zbatimi i masave korrigjuese dhe jo parandaluese. Mjediset, të cilat janë të prekura nga praktikakorruptive (dhe lidhjet kriminale që shpesh i shoqërojnë), edhe pse nuk kanë qenë ndonjëherë nën hetim gjyqësor, janë gjithsesi një mjedis, në të cilin zhvillimi dhe zbatimi efektiv i sistemit të menaxhimit nuk mund të ketë një qasje parandaluese, por korrigjuese, e cila do të kundërshtohet dhe me shumë gjasë do të drejtohet nga grupi, i cili ka interes të krijojë imazhin e praktikave të ligjshme, por që janë realisht në favor të praktikave korruptive. Në rastet kur shoqëria deklaron ekzistencën e situatave "kritike" gjyqësore, kjo shoqëri mund të jetë një klient i përshtatshëm për kryerjen e procesit të certifikimit me qasje "korrigjuese", por edhe për zhvillimin e praktikave parandaluese.

Në një situatë si kjo zhvillimi dhe zbatimi i sistemit të menaxhimit antikorrupsion konsiderohet si një masë me qëllim "kurues" për organizatën (masë e strukturuar në nivel sistemi), e cila (do të jetë objekt vlerësimi) mbështetet gjerësisht nga drejtoria, duke pasur si përparësi vendosjen dhe përhapjen në organizatë të kulturës së "përputhmërisë/konformitetit". Sistemi i menaxhimit antikorrupsion duhet të zbatohet në të gjitha proceset e shoqërisë, pasi lënia jashtë e disave prej tyre mund të pengojë zbatimin e tërë sistemit. Zbatimi i sistemit të menaxhimit kërkon përfshirjen e të gjitha proceseve organizative (edhe të atyre të dhëna në kontraktim të jashtëm), të paktën në fazën e analizës paraprake, dhe vetëm pasi të kryhet kjo analizë konteksti, mund të bëhet më pas një përzgjedhje e atyre proceseve (me argumentimin e duhur), të cilat konsiderohen jo kritike, dhe për të cilat vlerësimi i rrezikut mund të kufizohet vetëm në nivelin e tij të parë. Në mbështetje të sa më sipër është udhëzuesi në Shtojcën "A" të standardit ISO 37001, veçanërisht në paragrafin A.4.1 në lidhje me vlerësimin e rrezikut. Për këtë është i nevojshëm përcaktimi i një metodologjie të saktë për të shmangur përballjen me situata, në të cilat vihen në dukje anët e dobëta në strukturë dhe besueshmëri të organizatës.

5.2. PËRCAKTIM I NUMRIT TË PUNONJËSVE

Vlerësimi kryhet sipas përcaktimeve dhe rregullave që AXE REGISTER, si organizëm certifikues, duhet t'u përmbahet në bazë të totalit të punonjësve të përfshirë në veprimtari dhe procese të cilësuar si të ndjeshme nga organizata, përveç proceseve/funksioneve të përmendura në shënimin nr.1 të paragrafit 1 të kësaj rregulloreje.

Është e mundur të bëhen përshtatje në llogaritje në bazë të numrit të punonjësve të përfshirë në veprimtari dhe procese me rrezik të ulët korrupsionit, në varësi të informacionit që organizata ka deklaruar në kërkesën për ofertë, por duke përjashtuar punonjësit e përfshirë në veprimtari dhe procese të ndjeshme të përmendura në shënim nr.1.

Në rastet kur veprimtaritë dhe proceset e organizatës kryhen me kontraktim të jashtëm (p.sh. grupe ndërmarrjesh), në llogaritjen e punonjësve duhet të përfshihen edhe këta të fundit. Gjatë fazës 1 të auditit ose çdo audit të parë të nevojshëm, AXE REGISTER do të vlerësojë në funksion të rreziqeve të korrupsionit të identifikuara mënyrën e arsyetimit që ka ndjekur organizata në llogaritjen e punonjësve dhe do të bëjë verifikimet e duhura për përputhshmërinë e informacionit në lidhje me numrin e punonjësve të deklaruar sipas kontratës nga organizata dhe do të paraqesë këto gjetje në raportin e auditit.

Sipas dispozitave të rregullores, Grupi Auditues nuk duhet të kufizohet vetëm me analizën ekzistuese të rreziqeve të korrupsionit, por ka për detyrë të vlerësojë plotësinë e saj duke iu referuar kërkesave të zbatueshme të standardit ISO 37001 dhe rezultateve e reduktimeve të zbatuara nga organizata.

5.3. KOHËZGJATJA E AUDITIMIT

Llogaritja e ditëve të auditit kryhet sipas dispozitave të normës ISO/IEC 17021-1 dhe të dokumentit IAF MD 05, tabela EMS (sipas RG CE.01 - Rregullore për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit) në bazë të klasifikimit të ndërmarrjes sipas nivelit të rrezikut si “i lartë”, “i mesëm” ose “i ulët”. Vlerësimi i rrezikut kryhet sipas kriterëve të mëposhtme:

ORGANIZATA ME RREZIK TË LARTË

Përfshihen të gjitha organizatat që plotësojnë të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

- Organizata që në 5 vitet e fundit kanë qenë të përfshira në hetime gjyqësore për çështje të lidhura me korrupsionin;
- Administratat publike;
- Ente publike dhe ekonomike;
- Shoqëri me kontroll publik ose pjesëmarrje publike;
- Shoqëri, fondacione dhe ente të së drejtës private të financuara nga administrata publike ose ato, në të cilat tërësia e komponentëve të organeve administrative janë të caktuara nga administrata publike;
- Subjektet e sektorit të tretë (p.sh. organizata vullnetare, organizma për bashkëpunim) dhe kooperativat sociale;
- Shoqata (duke përfshirë partitë dhe sindikatat) me përfaqësim kombëtar;
- Urdhërat profesionale dhe kolegjet kombëtare;
- Kompanitë e transferuara në shtete të cilat kanë një vlerësim të Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit (CPI) më të ulët ose të barabartë me 30. Klasifikimi i korrupsionit i realizuar nga Transparency International. Në rastin e kompanive të transferuara në më shumë shtete, që bëjnë pjesë në fushën e certifikimit, merret për bazë indeksi i shtetit me rezultat më të ulët.
- Organizatat, jo Ndërmarrjet e Vogla e të Mesme (SME), në sektorët e mëposhtëm:
 - Shëndetësi
 - Ndërtim
 - Bankë dhe sigurime
 - Shërbime (gas, ngrohje, elektricitet, ujë, transport, komunikim, shërbime postale)

ORGANIZATAT ME RREZIK TË MESËM

Përfshihen të gjitha organizatat, të cilat nuk përfshihen në kategorinë e lartpërmendur dhe që plotësojnë të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

- Marrin kontribute, fonde dhe financime publike, kombëtare dhe ndërkombëtare në një masë që kapërcen 30% të të ardhurave të tyre vjetore;
- Marrin nga institucionet dhe shoqëritë publike ose nga institucionet ndërkombëtare shpërblime apo pagesa, duke përfshirë ato që përfitohen nga zbatimi i kontratave publike, në një masë që kapërcen 30% të të ardhurave të tyre vjetore.
- Organizata të transferuara në shtete të cilat kanë një votim të Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit në vlerën midis 31 dhe 59.
- Shoqëri tregtare, ndërmjetësimi apo trading, që nuk klasifikohen si Ndërmarrje të Vogla e të Mesme për nga niveli i faturimit.
- Organizatat me rrezik të lartë që rezultojnë të certifikuar prej të paktën 3 vitesh me akreditim EA/IAF MLA për standardin ISO 37001. Ky kusht nuk zbatohet, nëse organizata që kërkon certifikimin, në 5 vitet e fundit ka qënë e përfshirë në procedime hetimi që kanë lidhje me korrupsionin.

Organizatat të cilat nuk përfshihen në asnjë nga kategoritë e përmendura klasifikohen automatikisht si organizata me Rrezik të Ulët. Nuk zbatohet kategoria Rrezik i Kufizuar.

NB. Nuk zbatohet reduktim për ditët e auditit.

AXE REGISTER Sh.p.k.

Sheshi “Skënderbej”, Pallati i Kulturës

Nd. 9, H.6, Nr. 7, Njësia Administrative 2, 1001 Tiranë

Tel. +355 69 60 37 861

info@axe-register.com – www.axe-register.com

5.4. KRYERJA E AUDITIT

Zbatohet e njëjta metodologji si për sistemet e tjera të menaxhimit, ku cikli i certifikimit përfshin:

- auditin fillestar, të ndarë në Fazën e Parë dhe Fazën e Dytë (nëse rezultati i auditit të Fazës 1 nuk lejon kalimin në Fazën e 2 për mangësi të rëndësishme në sistem, Faza e Parë duhet të planifikohet përsëri, e plotë ose jo në varësi të rastit; koha e planifikimit midis Fazës së Parë dhe Fazës së Dytë duhet të jetë e mjaftueshme për të mundësuar planifikimin e duhur të Fazës së Dytë dhe të bëjë të mundur menaxhimin e problemeve të mundshme, të cilat në këtë fazë mund të paraqiten si jokonformitet). Të dyja fazat kryhen në mjediset e organizatës, pavarësisht përmasave të saj; mund të planifikohet që një pjesë e kohës së auditit, jo më shumë se 20%, të konsumohet off-site (jo pranë organizatës), sikurse parashikohet në rregulloren RG CE.01 të AXE REGISTER.
- auditin e mbikëqyrjes së parë;
- auditin e mbikëqyrjes së dytë;
- auditin për rinovimin e certifikatës.

Sipas nevojave mund të kryhen audite të tjera sipas RG CE.02 “Rregullore për certifikimin e sistemeve të menaxhimit - Transferimet”.

5.5. CERTIFIKIMI I ORGANIZATAVE ME SHUMË SELI (MULTI-SITE)

Zbatohet edhe këtu rregullorja RG CE.02 “Rregullore për certifikimin e sistemeve të menaxhimit” duke mos përjashtuar në kampionim ato seli, ku kryhen veprimtari ose procese që bartin rrezikun e korrupsionit, pra çfarë përfshihet në shënimin nr. 1 të paragrafit nr. 1 të këtij dokumenti (nëse ka), si dhe ato që dalin nga analiza e rrezikut të kryer nga organizata.

6. PËRGJEGJËSITË E PALËVE

6.1. TË PËRGJITHSHME

6.1.1 Detyrimet e Organizatës

Sipas RG CE.02 “Rregullores për certifikimin e sistemeve të menaxhimit”:

- Organizata e certifikuar ose në proces certifikimi duhet të njoftojë menjëherë AXE REGISTER në rastet kur ajo përfshihet në ndonjë situatë kritike, e cila mund të kompromentojë certifikimin e sistemit (të tilla si: përfshirja në ndonjë skandal, krizë ose përfshirja në ndonjë procedim gjyqësor për çështje të lidhura me korrupsionin ose të tjera të ngjashme me të).
- Organizata duhet të njoftojë menjëherë AXE REGISTER për çdo situatë që lidhet me fenomenin e korrupsionit, që mund të ketë përfshirë një ose më shumë burime njerëzore si dhe veprimet e kryera për të kufizimin e pasojave, analizën e shkakut dhe veprimet korrigjuese.

6.1.2 Detyrimet e AXE REGISTER

Në rast se AXE REGISTER vihet në dijeni drejtpërdrejtë nga organizata ose nga burime të tjera, kur organizata është përfshirë në ndonjë skandal ose proces gjyqësor për çështje të lidhura me korrupsionin, AXE REGISTER ka për detyrë (sipas kërkesave të rregulloreve të cilave duhet t’u përmbahet si organizëm certifikues) të kryejë menjëherë vlerësime dhe analiza specifike. Në raste të tilla AXE REGISTER do të procedojë me hetimet e nevojshme si dhe do të ndërmarrë veprimet dhe masat e duhura. Ajo mund të njoftojë tregun se organizata është “nën vëzhgim” (përveç rasteve kur është detyrim ligjor dhe kur është fjala për tregjet e rregulluara – si p.sh. bursa), mund të vendosë për arkivimin e sinjalizimit, të vendosë sanksione, të përforcojë veprimtaritë e auditimit, të cilat përcaktohen sipas përshtatshmërisë së përgjigjes dhe të strategjive të zbatuara nga organizata.